Republika e Kosovës
Republika Kosova – Republic of Kosovo

Komuna e Prishtinës
Opština Priština –Municipality of Prishtina

Diskutimi publik lidhur me Plotësim ndryshimin e rregullores 01.nr.110-2782 më2.12.2011 për Tarifa, Ngarkesa dhe Gjoba në komunën e Prishtinës

Data:04.06.2026
Vendi: Komuna e Prishtinës

Seanca e diskutimit publik u hap nga z. Osman Bllaca, zyrtar përgjegjës për organizimin e konsultimeve publike në Komunën e Prishtinës. Ai i përshëndeti të pranishmit dhe theksoi rëndësinë e këtij procesi si një instrument demokratik për përfshirjen e qytetarëve, bizneseve dhe grupeve të interesit në hartimin e politikave komunale. Ai sqaroi se konsultimet publike janë pjesë e obligimeve ligjore të komunës dhe kanë për qëllim përmirësimin e akteve para finalizimit të tyre.

Në fillim të seancës, ai kërkoi nga pjesëmarrësit të nënshkruhen në listën e prezencës dhe i njoftoi për rregullat e debatit, duke kërkuar që diskutimet të jenë të fokusuara, të argumentuara dhe brenda kornizës së respektit institucional.

Në këtë takim morën pjesë z. Luftar Braha, Dretor i Drejtorisë për Zhvillim Ekonomik dhe Inovacion, antarët e grupit punues për ndryshimin dhe plotësimin e Rregullores nr.01-110/2782, për tarifa, ngarkesa dhe gjoba, qytetarë, përgaqësues të bizneseve, shoqërisë civile, media, anëtarë të Kuvendit Komunal të Prishtinës.

Pas hapjes, z. Osman Bllaca i dha fjalën drejtorit z. Luftar Braha, i cili prezantoi në mënyrë të zgjeruar arsyet e hartimit të draft-rregullores.

z. Luftar Braha , theksoi se Prishtina si kryeqytet përballet me një rritje të vazhdueshme të presionit urban, i cili reflektohet në trafik të rënduar, ngarkesë të madhe në infrastrukturë, përdorim intensiv të hapësirave publike dhe rritje të aktiviteteve ekonomike në zona të kufizuara të qytetit. Sipas tij, kjo rregullore synon të krijojë një sistem më të drejtë dhe më të balancuar të menaxhimit të këtyre ngarkesave.

Ai shtoi se qëllimi i rregullores nuk është vetëm aspekti fiskal apo rritja e të hyrave komunale, por krijimi i një mekanizmi që e orienton zhvillimin urban në mënyrë më të qëndrueshme. Ai theksoi se konsultimi publik është një fazë thelbësore ku dokumenti mund të përmirësohet, të korrigjohet dhe të plotësohet sipas komenteve të qytetarëve dhe palëve të interesit.

Në vijim, ai theksoi se të hyrat eventuale nga kjo rregullore do të orientohen në projekte infrastrukturore si unaza e jashtme e qytetit, përmirësimi i transportit publik, zgjerimi i hapësirave të këmbësorëve dhe menaxhimi më efikas i mobilitetit urban, duke synuar një qytet më funksional dhe më të jetueshëm.

Pas prezantimit të draftit, fjala iu dha pjesëmarrësve.

Z. Gzim Sveqla, asambleist LVV, në fjalën e tij theksoi se nuk e kundërshton parimisht nevojën për rregullim të tarifave komunale, por kërkoi që çdo tarifë të mbështetet në analiza të thella ekonomike, financiare dhe ligjore. Ai ngriti shqetësimin se në draft mungon një metodologji e qartë për përcaktimin e tarifave sipas madhësisë së biznesit, qarkullimit vjetor dhe ndikimit real që aktivitetet ekonomike kanë në infrastrukturën urbane. Sipas tij, një sistem i tillë i përgjithësuar krijon pabarazi dhe nuk reflekton realitetin ekonomik të bizneseve në Prishtinë.

Ai gjithashtu kundërshtoi taksën hyrëse për automjetet që nuk janë të regjistruara në Prishtinë, duke argumentuar se një masë e tillë mund të cenojë lirinë e lëvizjes dhe të krijojë ndarje mes qytetarëve të komunave të ndryshme. Sipas tij, problemet e trafikut nuk zgjidhen me taksa, por me investime në transport publik dhe menaxhim më të mirë urban. Ai propozoi kategorizim të bizneseve në mikro, të vogla, të mesme dhe të mëdha, si dhe trajtim të veçantë për bizneset familjare dhe aktivitetet lokale.

Po ashtu, në fjalën e tij, pershendeti lehtesirat qe parashihen të aplikohen për bizneset e reja dhe për vajzat dhe grate pronare të biznesve.

Z. Kadri Bytyqi, kryetar i Odës së Farmacistëve të Kosovës, në fjalën e tij theksoi se barnatoret nuk mund të trajtohen si biznese të zakonshme tregtare, pasi ato janë institucione shëndetësore të rregulluara me ligj të veçantë. Ai shpjegoi se barnatoret funksionojnë nën standarde të rrepta profesionale, licencim specifik dhe mbikëqyrje institucionale, duke pasur rol direkt në sistemin shëndetësor publik.

Ai theksoi se çdo ngarkesë financiare apo tarifore duhet të marrë parasysh këtë natyrë specifike dhe të mos krijojë barazi të padrejtë me bizneset tregtare. Sipas tij, mungesa e një analize të tillë në draft e bën trajtimin e barnatoreve të padrejtë dhe të paqëndrueshëm.

Z. Sadudin Hasani, përfaqësues i bizneseve të vogla dhe kioskave, theksoi se bizneset e vogla kanë kapacitete të kufizuara financiare dhe nuk mund të përballojnë rritje të njëanshme të tarifave komunale. Ai kërkoi që të vendosen lehtësime të veçanta për mikro-bizneset, veçanërisht ato me sipërfaqe të vogël dhe qarkullim të ulët.

Ai propozoi që gratë sipërmarrëse, nënat vetëushqyese dhe bizneset fillestare të kenë trajtim të veçantë fiskal, si dhe sugjeroi krijimin e mekanizmave vullnetarë për kontribut në zhvillimin e qytetit, në vend të barrës së detyrueshme financiare.

Z. Besnik Berisha, kryetar i Odës së Avokatëve, theksoi se profesioni i avokatit është profesion i garantuar me Kushtetutë dhe i rregulluar me ligj të veçantë, prandaj nuk mund të trajtohet si aktivitet komercial apo biznes i zakonshëm. Ai argumentoi se vendosja e taksave komunale për ushtrimin e profesionit të avokatisë krijon konflikt juridik me legjislacionin në fuqi dhe cenon pavarësinë e këtij profesioni.

Ai kërkoi përjashtimin e plotë të avokatëve nga kjo rregullore, duke paralajmëruar se çdo tentim për aplikim të tillë do të pasohej me reagime institucionale dhe juridike.

Znj. Fjolla Vukshinaj, anëtare e Kuvendit Komunal, propozoi zgjerim e kategorive të ccilat do të lirohen nga taksat, përfshirë kategori sociale dhe profesionale të ndjeshme.

Ajo gjithashtu kërkoi transparencë digjitale të plotë të të gjitha tarifave komunale, në mënyrë që qytetarët të kenë qasje të lehtë dhe të drejtpërdrejtë në informacion. Sipas saj, një model modern i taksimit duhet të përfshijë zonën e qytetit, sipërfaqen e biznesit dhe qarkullimin vjetor.

Znj. Besa Shahini, asambleiste PSD, e konsideroj draftin e publikuar si të paplotë dhe jo të harmonizuar me nevojat reale të qytetit. Ajo kundërshtoi taksën hyrëse prej 10 euro, duke theksuar se ajo nuk adreson shkaqet reale të trafikut në Prishtinë, të cilat lidhen me mungesën e transportit publik efikas, menaxhimin e dobët të ndërtimit dhe organizimin e qarkullimit urban.

Z. Avi Gashi, aktivist qytetar, kërkoi tërheqjen e plotë të draftit, duke argumentuar se ai është i papërshtatshëm në kushtet aktuale ekonomike dhe të inflacionit. Ai theksoi se çdo rritje e tarifave do të reflektohet tek qytetarët dhe jo tek bizneset, duke krijuar barrë të padrejtë sociale.

Z. Gent Sejdiu, projekt-menaxher për reformën e transportit public në Kryeqytet, theksoi se masa të ngjashme aplikohen në qytete të ndryshme evropiane dhe kanë dhënë rezultate pozitive në menaxhimin e trafikut dhe përmirësimin e cilësisë së jetës urbane. Ai argumentoi se kufizimi i qarkullimit në zona të caktuara është praktikë moderne e mobilitetit urban.

Z. Avni Jashari, përfaqësues i Odës së Avokatëve, përsëriti se drafti bie ndesh me Kushtetutën dhe ligjet që rregullojnë profesionin e avokatit dhe kërkoi përjashtimin e këtij profesioni nga çdo formë e taksimit komunal.

Z. Asdren Bytyqi, avokat, theksoi se rregullorja krijon diskriminim ndërmjet profesioneve të ndryshme dhe është juridikisht e cenueshme. Ai paralajmëroi se miratimi i saj në këtë formë mund të sjellë sfida ligjore dhe pasoja për zbatimin e saj në praktikë.

Z. Liridon Saliu nga Grupi për Studime Juridike dhe Politike, theksoi se drafti i rregullores, kërkon analizë më të thelluar ligjore dhe ekonomike, duke vënë në pah se disa dispozita mund të jenë në kundërshtim me parimet kushtetuese dhe legjislacionin në fuqi.

Znj. Jeta Berisha, aktiviste për mjedisin dhe barazinë gjinore, kritikoi taksën hyrëse dhe disa tarifa për bizneset e vogla, duke argumentuar se ato krijojnë pabarazi sociale dhe godasin më shumë shtresat me të ardhura të ulëta, studentët dhe qytetarët e zakonshëm që varen nga shërbimet e kryeqytetit.

Në vazhdim të debatit, z. Luftar Braha dha sqarime shtesë, duke theksuar se taksa hyrëse aplikohet vetëm në një zonë të kufizuar urbane dhe jo në të gjithë qytetin. Ai theksoi se qëllimi i saj është menaxhimi i hapësirës publike dhe ulja e ngarkesës në trafik, jo krijimi i barrës fiskale për qytetarët.

Ai gjithashtu u shpreh i hapur për përmirësime të draftit dhe pranoi se konsultimi publik ka për qëllim pikërisht identifikimin e gabimeve dhe korrigjimin e tyre.

Z. Osman Bllaca, theksoi se të gjitha komentet e dhëna gjatë debatit, si dhe ato që do të dorëzohen me shkrim, do të shqyrtohen nga grupi punues dhe drejtoria përkatëse, dhe se nëse është e nevojshme mund të organizohen edhe konsultime të tjera publike pas rishikimit të draftit, pasi që një gjë e tillë u kërkua nga të panishmit.

Znj. Ganimete Xhelili, kryetare e Odës së Ndërmjetësuesve të Kosovës, kërkoi rishikimin e tarifës për ndërmjetësuesit, duke shtuar se ky profesion ka natyrë specifike, nivel të ulët të tarifimit dhe funksion të veçantë në sistemin e drejtësisë alternative, prandaj nuk mund të trajtohet njësoj si aktivitetet tjera ekonomike.

Z. Arlind Dervodeli nga barnatorja Riga Pharm ngriti shqetësime për rritjen e tarifave dhe ndikimin e tyre në funksionimin e barnatoreve, duke theksuar se punonjësit dhe furnitorët e tyre udhëtojnë çdo ditë në Prishtinë dhe do të preken drejtpërdrejt nga çdo rritje e kostove.

Z. Astrit Gashi nga Lidhja e Bizneseve të Kosovës kërkoi përfshirje më të madhe të grupeve të interesit në fazat e hartimit të rregullores dhe ngriti shqetësime për ndikimin e taksës hyrëse në qytetarët që vijnë në Prishtinë për shërbime shëndetësore dhe nevoja esenciale.

z. Luftar Braha, pëseriti se taksa hyrëse do të aplikohet vetëm në unazën e brendshme të qytetit, dhe se komuna është në proces të zgjerimit të transportit publik dhe përmirësimit të qarkullimit urban.

Z. Clirim Gerbeshi asamblesit LVV, kërkoi heqjen e nenit që parasheh taksën hyrëse dhe deklaroi se shumica e pjesëmarrësve janë kundër këtij elementi të draftit në formën aktuale.

Z. Avi Gashi ngriti sërish shqetësime për barrën ekonomike dhe ndikimin e inflacionit, duke kërkuar rishikim të përgjithshëm të draftit dhe më shumë analiza para miratimit përfundimtar.

Z. Zeqir Lushaku nga Shkolla e gjuhëve të huaja kërkoi heqjen e kësaj veprimtarie nga lista e tarifimit, duke argumentuar rënien e kërkesës për kurse fizike dhe rëndësinë e kësaj veprimtarie në edukimin e të rinjve.

Në përmbyllje të seancës, pjesëmarrësit ngritën edhe çështje të tjera lidhur me menaxhimin e trafikut, infrastrukturën rrugore dhe funksionimin e institucioneve komunale dhe policore. Drejtori z. Luftar Braha theksoi se komuna është në bashkëpunim të vazhdueshëm me Policinë e Kosovës dhe se sistemi i transportit publik është në zgjerim, me autobusë që operojnë çdo ditë dhe me një numër të madh qytetarësh që e shfrytëzojnë atë

Në fund, z. Osman Bllaca falënderoi të gjithë pjesëmarrësit për kontributin e dhënë dhe e shpalli të mbyllur konsultimin publik, duke theksuar rëndësinë e këtij procesi për transparencën dhe përmirësimin e rregullores komunale.

Republika e Kosovës
Republika Kosova – Republic of Kosovo

Komuna e Prishtinës
Opština Priština –Municipality of Prishtina

PRISHTINA

Lista e nënshkrimeve për "Diskutimin publik lidhur me ndryshimin dhe plotësimin e Rregullores, 01. Nr. 110-2782, më 02.12.2011, për tarifa, ngarkesa dhe gjoba komunale".
4.6.2026, Prishtinë.

Kryeqyteti - Prishtinë / Kuvendi Komunal

Nr.	Emri/Name	Mbiemri/Surname	Titulli/Title	e-mail	Nënshkrimi/Signature
1	ADEM ~~SYLEJMANI~~	SYLEJMANI	KL. KODRA E. [illegible]		
2	SADUDIN ~~HASANI~~	HASANI	SHOQATA B. VOGL		
3	Gent	Sejdiu	Qytetar		
4	LIRIDON	SALIHI	GLPS		
5	Elona ~~Kurti~~	Kurti	GLPS		
6	BESNIK BER[illegible]		OAK		
7	AVNI JASHARI		AVOKAT		
8	BLEDAR	GASHI	AVOKAT		
9	Shemdi	Bunjaku.	AVOKAT		
10	Veton	Kobaj	Avokat		

***P.S** *Të dhënat tuaja personale do të përdoren vetëm për qëllime të evidentimit të pjesëmarrësve në konsultim publik dhe nuk do të përdoren për qëllime tjera!*
Pjesëmarrësit janë të njoftuar se gjatë diskutimeve publike, do të fotografohet dhe do të publikohen!

Nr.	Emri/Name	Mbiemri/Surname	Titulli/Title	e-mail	Nënshkrimi/Signature
11	Labimot	Bazuku	Avokat-OAK		
12	Asdron	Bytyqi	Avokat		
13	Ron	Sopi	OSK		
14	Ariana	Bektashi	DSHP		
15	Rejhane	Xobani	DSHP		
16	Fiona	Bakija	Ekologe		
17	Lyra	Bakija Vula	Urbaniste		
18	Genti	Xharavima	Dizajn eco		
19	Jeta	Berisha	Aktiviste		
20	Gizonit ~~Salihaj~~	Salihaj	Farmacist		
21	Vebi	Mujku	Kirkillton		
22	JETEDONA KOMUNHERI	KODRAZIU	Tek. farmacise		
23	Tuana	Arifi	Tek. e farmacisë		
24	GËZIM	SUEQLA	K. KOMUNAL		
25	Çlirim	Gërbeshi	K. KOMUNAL		
26	Avdyl	GASHI	Qytetar		
27	BESA	SHAHINI	ASAMBLEISTE		
28	ZEQIR	LUSHAKU	DREJTOR		

*P.S *Të dhënat tuaja personale do të përdoren vetëm për qëllime të evidentimit të pjesëmarrësve në konsultim publik dhe nuk do të përdoren për qëllime tjera!*

Pjesëmarrësit janë të njoftuar se gjatë diskutimeve publike, do të fotografohet dhe do të publikohen!

Nr.	Emri/Name	Mbiemri/Surname	Titulli/Title	e-mail	Nënshkrimi/Signature
29	GANIMETE	XHELILI	KRYETARE (ODA E NDËRMJE		
30	AGON	MALIQI	Menaxhe TË SUESVE) Riga Pharm		
31	Arlind	Dërvodeli	Riga Pharm		
32	ILIR	LUTHA	BARNATORE		
33	FLORINA	BERISHA	ShFarim K		
34	KADRI	BYTYQI	ODA E FARMACISTE		
35					
36					
37					
38					
39					
40					
41					
42					
43					
44					
45					
46					